



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/04-15894 dt. 14.04 2021

Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
26. 03.2021

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë: **26.03.2021**

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 31, anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 26. 02. 2021.
2. Propozim Statuti i Qendrës së Mjekësisë Familjare „Dr. Hafir Shala” Drenas (Gllogoc)
3. Draft-Raport i tretë periodik për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
4. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të KK të datës 26 /03/ 2021 ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Nënkyetari Arben Shala, Shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, këshilltarët e KK, drejtorët e Drejtorive përkatëse dhe zyra e informimit.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj; e falenderioi ish nënkryetarin Nazmi Hasi për punën sa ishte nënkryetar i Komunës si dhe i uron suksese nënkryetarit Arben Shala. Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoj se prezent në mbledhje janë 31, pjesëmarrës. Prezantoi rendin e ditës, a ka dikush diçka rreth rendit të ditës nëse nuk ka atëherë e hedhim në votim.

Votim për rendin e ditës u përkrah në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 26.02.2021.** Ka diskutime nuk ka hedhim në votim, pra votohet në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dytë **2. Propozim Statuti i Qendrës së Mjekësisë Familjare „Dr. Hafir Shala” Drenas (Gllogoc).**

Pasi nuk pati debat për këtë pikë atëherë u hodh në votim , edhe kjo pikë u votua në mënyrë unanime.


Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e teret 3.Draft-Raport i tretë periodik për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Diskutime nuk pati edhe kjo pikë kalojë në mënyrë unanime .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e 4. Të ndryshme. Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 10: 20 min.


Procesmbajtëse:



Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit


Labinot Halilaj